

Rezyme e shkurtër

Përbërja optimale e pasurive dhe detyrimeve në bankat komerciale është një çështje komplekse dhe domethënëse dhe paraqet sfidë si për menaxhmentin e bankës ashtu edhe për rregullatorët. Studiuesit vazhdojnë përpjekjet për të kuptuar se si bankat përcaktojnë strukturën e pasurive dhe detyrimeve të tyre për të përmbushur objektivat e aksionarëve dhe menaxhmentit. Ndërkohë që disa vendime mbi strukturën e pasurive dhe detyrimeve mund të jenë strategjike dhe të merren nga bordi i bankës, është thelbësore që bankat të krijojnë një mekanizëm të automatizuar për të udhëhequr këto vendime. Bankat kërkojnë vazhdimisht strategji optimale për menaxhimin e pasurive dhe detyrimeve të tyre, duke përdorur mjete analitike gjithëpërfshirëse dhe sisteme mbështetëse fleksibël për të planifikuar dhe raportuar në mënyrë efektive të dhënat financiare.

Menaxhimi efikas i pasurive dhe detyrimeve luan një rol kryesor në arritjen e stabilitetit financiar dhe përfitimit afatgjatë për bankat. Për të lehtësuar këtë proces, aplikimi i një modeli të përshtatshëm optimizimi bëhet imperativ. Në këtë studim, ne propozojmë Modelin Statistikor të Kontabilitetit Kostos, si një model i cili ekzaminon lidhjen në mes të profitabilitetit dhe strukturës së pasurive dhe detyrimeve në bankat në Kosovë përgjatë periudhës 2013-2021. Duke shfrytëzuar 4 kategori të pasurive, tri kategori të detyrimeve dhe tri kategori jashtë bankave si ajo e GDP-se për kokë banori, Inflacioni dhe EURIBOR, hulumtimi ka testuar efektin e menaxhimit të tyre në qëndrueshmërinë e profitabilitetit të bankave përmes dy variabëlve të profitabilitetit, të hyrat nga interesi (H1) dhe të hyrat neto (H2). Punimi analizon tutje se si lidhja në mes të menaxhimit i pasurive dhe detyrimeve dhe profitabiliteti shihet në mostrat e bankave me pronësi të ndryshme të kapitalit.

Për tu thelluar më tutje hulumtimin tonë, kemi analizuar edhe faktorët të cilët ndikojnë në Margjinën Neto të Interesit të bankave, si indikator i matjes së performancës së sektorit bankar, për periudhën 2013-2019.

Objekivi i këtij hulumtimi është të eksplorojë përfitimet e mundshme të përdorimit të modeleve për të përmirësuar menaxhimin e pasurive dhe detyrimeve në bankat e Kosovës. Duke analizuar të dhënat historike dhe duke përdorur teknika statistikore, punimi i doktoratës synon të ofrojë njohuri të vlefshme për shpërndarjen dhe përdorimin optimal të pasurive dhe detyrimeve, duke çuar në përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmërisë financiare në bankat në Kosovë.

Përmes një rishikimi gjithëpërfshirës të literaturës përkatëse, analizës së detajuar të zhvillimit të sektorit bankar në Kosovë, përputhshmërinë me rregullativat e sektorit bankar dhe analizës së të dhënave empirike, ky studim synon të vlerësojë efikasitetin e modelit në kontekstin e sektorit bankar të Kosovës. Duke identifikuar përcaktuesit kryesorë të optimizimit të pasurive dhe detyrimeve dhe duke vlerësuar ndikimin e tyre në performancën e qëndrueshme, ky hulumtim kontribuon në njohuritë ekzistuese në lidhje me praktikën efektive të menaxhimit bankar.

Gjetjet e hulumtimit ofrojnë njohuri të dobishme për menaxhmentin e bankës nëpërmjet identifikimit e pasurive që gjenerojnë kthimin më të lartë dhe detyrimeve të cilat krijojnë shpenzime me të ulta. Konkretisht, bankat duhet të fokusohen në rritjen kualitative të portofolit të tyre të kredisë, optimizimin e investimit në letra me vlerë, investimeve afatshkurtër në banka korrespondente dhe parave të gatshme. Gjithashtu optimizimi i detyrimeve është më se i domosdoshëm në mënyrë që të krijohet siguri nga baza e financimit. Bankat nuk mund të ju

shmangen faktorëve të jashtëm andaj duhet të marrin në konsideratë ndikimin e faktorëve makroekonomikë si GDP, inflacionin dhe Euribor-in në performancën e tyre bankare.

Gjetjet e këtij studimi pritet të ofrojnë implikime praktike për profesionistët bankar, politikëbërësit dhe palët e interesuara në industrinë financiare të Kosovës. Duke theksuar rëndësinë e përdorimit të një modeli të fuqishëm optimizimi, siç është Modeli statistikor i kontabilitetit të kostos (SCA), vendimmarrësit mund të lundrojnë më mirë në kompleksitetin e menaxhimit të pasurive dhe detyrimeve, duke promovuar në fund stabilitetin dhe përfitimin afatgjatë të bankave.

Fjalë kyçe: Menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve (ALM), Net interes Margjina (NIM). Performancë e qëndrueshme, Modeli statistikor i kontabilitetit të kostos (SCA), Sektori bankar, Rregulloret bankare.